Raporti individual i konsultimit publik

1. Titulli i projekt aktit

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9587/2006 ‘Për mbrojtjen e biodiversitetit’”.

Qëllimi i këtij projektligji është përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor ekzistues për mbrojtjen e biodiversitetit, nëpërmjet ndryshimeve dhe shtesave në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar, me synim përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit.

Nëpërmjet këtij harmonizimi synohet forcimi i kuadrit ligjor kombëtar për mbrojtjen e habitateve natyrore, të llojeve të florës dhe faunës së egër, si dhe përmirësimi i masave për ruajtjen, menaxhimin dhe monitorimin e tyre.

Gjithashtu, synohet forcimi i mekanizmave institucionalë për monitorimin, raportimin dhe zbatimin e detyrimeve në fushën e biodiversitetit, përfshirë përcaktimin e autoriteteve përgjegjëse, procedurave administrative dhe instrumenteve të kontrollit.

Në tërësi, ky projektligj ka për qëllim krijimin e një kuadri ligjor më të plotë, më të harmonizuar dhe më efikas, i cili kontribuon në ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes së biodiversitetit në vend, si dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian të Republikës së Shqipërisë.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë 4.6.2026 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJK, të gjitha palët e interesuara: 1) organet publike; 2) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit; ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe

rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik në Ministrinë e Mjedisit.

Data e mbylljes së procesit të konsultimit publik ishte 2.7.2026.

Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9587/2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"", relacioni përkatës si dhe njoftimi për konsultimin publik u publikuan në linkun, www.konsultimipublik.gov.al.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese…, dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Projektligji, në zbatim të ligjit 146/2014, i është nënshtruar procesit të konsultimit publik, në portalin "Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike", nga data 4.6.2026 deri në datën 2.7.2026. Përgjatë kësaj periudhe ka patur 619 shikime në RENJKP, si dhe janë regjistruar 7 komente.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.
Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.
Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektligji është hartuar nga Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në fushën e mjedisit.

Gjatë procesit të konsultimit janë paraqitur komente dhe sugjerime nga palë të interesuara, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së tij. Në kuadër të këtij procesi, komente dhe sugjerime janë paraqitur nga z. Rihat Doci, arkitekt i sistemit AKRD si dhe nga Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri – FIAA, të cilat janë shqyrtuar nga grupi i punës gjatë finalizimit të projektaktit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuara sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Justifikimi
Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9587/2006 'Për mbrojtjen e biodiversitetit'".	1. A do të ndikojnë këto dispozita në procedurat e lejeve mjedisore, VNM-ve ose zgjerimin e impianteve industriale ekzistuese?"	Marinela Jazoj- Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri– FIAA.	Refuzohet	Dispozitat e propozuara nuk krijojnë procedura të reja autorizimi, leje apo miratime mjedisore dhe nuk vendosin kufizime të drejtpërdrejta shtesë për aktivitetet ekonomike ose impiantet industriale ekzistuese. Qëllimi i tyre është të sigurojnë që, gjatë proceseve ekzistuese të planifikimit territorial, zhvillimit dhe vlerësimit mjedisor, të merren në konsideratë

				edhe veçoritë e peizazhit që kanë rëndësi për ruajtjen e lidhshmërisë ekologjike të habitateve dhe llojeve të egra. Çdo ndikim i mundshëm mbi projekte konkrete do të vlerësohet rast pas rasti, në përputhje me legjislacionin në fuqi për VNM-në, VSM-në dhe planifikimin e territorit. Projektligji nuk ndryshon kriteret ekzistuese për dhënien e lejeve mjedisore dhe as procedurat për zgjerimin e aktiviteteve industriale ekzistuese.
	2. Veçoritë e peizazhit me rëndësi madhore – kush do t'i identifikojë dhe regjistrojë këto zona dhe si do të informohen operatorët nëse	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri– FIAA.	Refuzohet	Projektligji nuk parashikon identifikim apo shpallje automatike të veçorive të peizazhit me

	aktiviteti ose prona e tyre preket nga një klasifikim i tillë?"			rëndësi madhore. Në nenin 16, pika 5, parashikohet që kriteret, procedurat për identifikimin, hartëzimin, regjistrimin, administrimin dhe monitorimin e tyre të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në kuadër të këtij akti nënligjor do të përcaktohen: institucionet përgjegjëse për identifikimin dhe regjistrimin; procedurat e hartëzimit dhe publikimit të të dhënave; mënyra e integrimit të tyre në instrumentet e planifikimit të territorit; mekanizmat e informimit të

				publikut, pronarëve dhe operatorëve ekonomikë të interesuar. Gjithashtu, projektligji parashikon që këto veçori të pasqyrohen në instrumentet e planifikimit të territorit dhe planet/programet sektoriale, çka garanton akses publik dhe transparencë për palët e interesuara. "Identifikimi i veçorive të peizazhit me rëndësi madhore nuk krijon në vetvete status të ri mbrojtjeje apo kufizime automatike mbi pronën private ose aktivitetet ekonomike, por shërben si instrument planifikimi dhe

				konsiderohet në proceset ekzistuese të vlerësimit dhe vendimmarrje

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9587/2006 ‘Për mbrojtjen e biodiversitetit’”	1. Analiza e Arkitekturës së Monitorimit (Nenet 6, 10, 11, 14, 15) Projektligji parashikon në Nenin 6, 11 dhe 14 detyrime të shtuara për monitorimin, raportimin dhe krijimin e regjistrave të autorizimeve për përjashtimet dhe aksesin në burime gjenetike. Vërejtje: Relacioni (Pika III dhe VI) evidenton mungesën e "gjurmueshmërisë" si një problematikë kryesore. Propozim: Krijimi i një regjistri fizik ose administrativ është i pamjaftueshëm. Kërkoj që në dispozitat zbatuese të sanksionohet detyrimi për ndërtimin e një Sistemi të Integruar Digjital (Integrated Biodiversity Monitoring System -	Rihat Doçi System Architect & Developer	Refuzohet	Projektligji parashikon mekanizma për monitorimin, regjistrimin dhe raportimin. Ngritja e një sistemi të ri të integruar digjital dhe ndërveprimi me sisteme të tjera nuk vlerësohet i domosdoshëm të përcaktohet në nivel ligji

	IBMS). Ky sistem duhet të mbështetet në arkitekturë API-based për ndërveprueshmëri të plotë me sistemet e tjera të qeverisjes elektronike (G-Posta, e-Albania), duke garantuar Audit Trail (gjurmueshmëri të auditueshme) për çdo autorizim.			
	2. Përafrimi me standardet e Protokollit të Nagojës dhe BE-së (Nenet 14, 15) Për sa i përket aksesit në burime gjenetike dhe ndarjes së përfitimeve (ABS), kërkohet përdorimi i Identifikuesve Digjitalë të Burimeve (Digital Object Identifiers). □Propozim: Udhëzimet e ministrit (Neni 15) duhet të përcaktojnë specifikimet teknike për standardin e të dhënave, duke siguruar që certifikatat e pajtueshmërisë të jenë të lexueshme nga maki		Refuzohet	Projektligji parashikon përdorimin e identifikuesve unikë, kur janë të disponueshëm, si dhe përditësimin e të dhënave në sistemin elektronik ABS Clearing-House. Përcaktimi i detyrueshëm i DOI-ve dhe i formateve specifike teknike nuk vlerësohet i nevojshëm.

	3. Zbatueshmëria dhe Buxhetimi (Pika IX e Relacionit) Vlerësoj se deklarimi në pikën IX se "projektligji nuk ka efekte financiare shtesë" është në kundërshtim me ambicien për monitorim efikas. □ Argumentim: Zbatimi i sistemeve manuale për monitorimin e vrasjeve incidentale (Neni 10) dhe raportimin 2-vjeçar te Komisioni Europian (Neni 11) do të shkaktojë kosto operacionale më të larta se investimi në teknologji. □ Propozim: Kërkoj që në aktet nënligjore (të cilat do të miratohen brenda 12 muajve sipas Nenit 18), të parashikohet "Buxhetim për Zhvillim Teknologjik", duke integruar kosto të certifikueshme për ndërtimin e platformës digjitale të monitorimit, e cila duhet të akomodohet në tabelën financiare të		Refuzohet	Propozimi për një zë të posaçëm buxhetor për zhvillimin teknologjik nuk mbështetet në një analizë konkrete të kostove dhe përfitimeve të sistemit të propozuar.

	Ministrisë për vitin pasardhës.			
	4. Koordinimi Ndërinstitucional (Pika VII dhe VIII) Duke qenë se në procesin e hartimit janë përfshirë Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) dhe institucionet kërkimore (Instituti i Resurseve Gjenetike): □ Propozim: Kërkoj që MEI të vlerësojë "Koston e mos-veprimit digjital". Përpara miratimit të VKM-ve në zbatim të këtij ligji, duhet të zhvillohet një Feasibility Study teknike për ndërtimin e infrastrukturës digjitale, me qëllim shmangien e mbivendosjes së sistemeve të monitorimit midis AKM, AKZM dhe Institutit të Resurseve Gjenetike.		Refuzohet	Projektligji përcakton përgjegjësitë institucionale dhe mekanizmat e zbatimit. Një studim i posaçëm fizibiliteti për ngritjen e platformës digjitale nuk vlerësohet i domosdoshëm në këtë fazë.
	5.Rekomandim për aktet nënligjore (Neni 18) Afati 12-mujor për miratimin e akteve nënligjore duhet të jetë i ndarë në faza:		Refuzohet	Afati 12-mujor i parashikuar në dispozitën kalimtare lidhet me nxjerrjen e aktit nënligjor

	1. Faza 1 (Muaji 1-4): Miratimi i kornizës së kërkesave teknike (Technical Requirements) për sistemet e monitorimit. 2. Faza 2 (Muaji 5-8): Zhvillimi i arkitekturës së platformës dhe testing i ndërveprueshmërisë. 3. Faza 3 (Muaji 9-12): Trajnimi i strukturave inspektuese dhe aktivizimi i regjistrave digjitalë. Konkluzion: Ky projektligj ka potencial të bëhet një standard për menaxhimin e biodiversitetit vetëm nëse mekanizmat e kontrollit nuk mbeten në formë letre, por shndërrohen në shërbime digjitale të verifikueshme në kohë reale.			për veçoritë e peizazhit dhe jo me zhvillimin e një platforme digjitale. Për rrjedhojë, ndarja e këtij afati në faza për zhvillimin e platformës nuk është e përshtatshme.

Nga 7 (shtatë) komentet e refuzuara gjatë procesit të konsultimit publik, 6 komente janë vlerësuar se lidhen me çështje jashtë objektit të projektaktit, ndërsa 1 (një) koment trajton çështje që parashikohen të rregullohen nëpërmjet një akti nënligjor. Nuk janë evidentuar komente të refuzuara për shkak të ndërhyrjeve jashtë kompetencës së institucioneve të qeverisjes qendrore apo për shkak të mospërputhjes me procedurat dhe afatet e institucioneve të Bashkimit Evropian në kuadër të përafrimit me acquis.

Bazuar në arsyetimet e paraqitura në pikën 5 të raportit të konsultimit publik, 7 komentet e refuzuara mund të grupohen si më poshtë:

1. **Komente jashtë objektit të projektaktit – 6 komente**

1. Ndikimi në procedurat e lejeve mjedisore, VNM-ve dhe zgjerimin e impianteve industriale – Projektligji nuk ndryshon procedurat ekzistuese të lejeve dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis.
2. Krijimi i një sistemi të integruar digjital për monitorimin e biodiversitetit (IBMS) – Ngritja e platformës digjitale dhe specifikimet e saj teknike nuk janë objekt i këtij projektligji.
3. Përdorimi i detyrueshëm i identifikuesve digjitalë (DOI) për burimet gjenetike – Përcaktimi i standardeve specifike teknike nuk është konsideruar i nevojshëm në nivel ligji.
4. Parashikimi i buxhetit të posaçëm për zhvillimin e platformës digjitale – Propozimi nuk mbështetet në një analizë konkrete të kostove dhe përfitimeve.
5. Kryerja e një studimi fizibiliteti për infrastrukturën digjitale – Nuk është konsideruar i domosdoshëm në kuadër të këtij projektligji.
6. Ndarja e afatit 12-mujor për aktet nënligjore në faza të zhvillimit të platformës digjitale – Afati i parashikuar në projektligj lidhet me miratimin e aktit nënligjor për veçoritë e peizazhit dhe jo me krijimin e një platforme digjitale.

2. Koment që trajtohet në një akt tjetër nënligjor – 1 koment

Identifikimi, regjistrimi dhe informimi i operatorëve për veçoritë e peizazhit me rëndësi madhore - Komenti është refuzuar pasi projektligji parashikon që kriteret, procedurat e identifikimit, hartëzimit, regjistrimit dhe informimit të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 16, pika 5.